



ZYRA E KRYETARIT

01/351-28389/24

23.08.2024

Bazuar ne nenin 81 te Ligjit e Prokurimit Publik nr. 04/L-042 I ndryshuar dhe amandamentuar me LPP nr, 04/l-237 atë Nr. 05/L-068 dhe Nr.05/L-092 , mbi Aktivitetet e Menaxhimit te projektit dhe kontratës, ZKA , bie këtë :

V E N D I M

Qe për Menaxhimin e kontratës nr. 74-2024 - te datës 23.08.2024 me numër te prokurimit 634-24-6218-5-2-1 Titull: Asfaltimi I rruges Poterq-Dugajeve

Për menaxhim te kontratës do te jete z. ARJETA 000AJ nga Drejtoria e Urbanizimit derisa Menaxheri i projektit i njesise kerkuese, si bartës i aktiviteve te programit , dhe implementues i projektit Enver Berisha

Plani për implementim e kontratës 20 muaj.

Vlera e kontratës është 204.000.00 Euro

- Menaxheri i projektit ,si edhe përgjegjësi për menaxhimin e kontratës , do te bëje raport të punëve dhe përcjellje për pranim.
- Kryesuesi i aktivitetit te kontrates do te informoj ne gjithsecilën faze te aktiviteve zyrën e prokurimit, dhe pas perfundimit te kontrates sjelle ne Zyre te prokurimit raportin detal mbi aktivitetin e menaxhimit te kontratës.
- Vendimi do te i dorzohet menagjerit te projektit së bashku me kontrate, ofertën financiare.
- Vendimit i bashkëngjiten : kontrata, sigurimi i ekzekutimit.

ZKA – KRYETARI
z. ZENUN ELEZAJ





KOMUNA KLINE

Zyra e prokurimit

Nr. 351-28389/24

DATE 23.08.2024

KONTRATË NR.74-2024

Numri i kontratës:¹ 634-24-6218-5-2-1/C785

KUVENDI KOMUNAL I KLINËS, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë; dhe

" REA" SH.P.K., ABEDIN REXHA, KLINË, (në vazhdim "Kontraktuesi"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për punë e shënuara me poshtë:

Asfaltimi i rrugës Poterq-Dugajeve me numër identifikues: 634-24-6218-5-2-1

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës është ekzekutimi i punëve në vijim nga ana e Kontraktuesit: Pune ndertimore asfaltimi i rrugve projekt Projekt tre vjeçarë viti 2024 te bugjetura 50,000.00 Euro Viti 2025 te bugjetura 106,000.00 Euro viti 2026 te bugjetura 49,000.00 Euro total 205,000.00 Euro

No.	Lot
1	Asfaltimi i rrugës Poterq-Dugajeve

Neni 2 Çmimi

2.1 Çmimi total i punëve duhet të jetë: 204,000.00 €; dyqind e katërmijë Euro.

2.2 Plani dinaiq është 20 muaj kalendarik.

2.3 Sigurimi i ekzekutimit do të jete 20,400.00 euro me validitet 20 muaj + 1 muaj= 21 muaj

2.4 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e veimja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borbh Kontraktuesit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

2.5 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

¹ Ju lutemi referojuni këtij numri të kontratës në dokumentet e fakturimit dhe pagesës, procedurat dhe transaksionet që lidhen me thesarin.

Ne baze te situacioneve mbi kryerje te punimeve me Raport nga Organi Mbikqyres dhe Fature

- Mbatjtja e paras ne vlere 20,400.00 € do te paguhet pas Afatit te garancionit te punimeve mbas 12 muajeve pas pranimit te perkoheshem teknik . Kjo mund te paguhet me garancion nese eksistojn mjetet ne dispozicion)

Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

Marrëveshja e kontratës;

Kushtet e Veçanta të Kontratës;

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;

Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;

Oferta financiare (Paramasa dhe Parallogaria);

Sigurimi i ekzekutimit

Plani dinamik

Menaxheri i kontratës

Arbk e biznesit

Vertetimi i ATK

Vertetimi i Gjykates

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 4 Komunikimet

4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.

4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe² në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.

Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	Labinot Morina
Pozita:	Zyrtar përgjegjës i prokurimit
Nënshkrimi:	
Data:	
Vula:	

Për Kontraktuesin

Emri:	<i>Minor Kostali</i>
Pozita:	<i>Menaxher</i>
Nënshkrimi:	
Data:	<i>23.08.2024</i>
Vula:	

² Gjuha do të jetë gjuha e shfrytëzuar nga tenderuesit në këtë tender.

ASFALTIMI I RRUGËVE : NË FSHATIN POTERO - DUGAJEV

1. PARAMASA PËR ASFALTIMIN E RRUGËS SIPAS SITUACIONIT TË RRUGËVE TË SPECIFIKUAR NË PROJEKT (PJESA GRAFIKE)

Nr. vendor	Përshkrimi i pozicioneve	Njësia	Sasia	Çmimi njësi (€)	Çmimi total me TVSH (€)
Të gjitha punët në përputhje me normat teknike dhe standartet Europiane dhe bashkëkohshme. Kompania punë kryese është përgjegjëse për të marrë masat mbrojtëse dhe të sigurisë për punëtorët me anijet signalizuese para fillimit të punës, nëgjithë zonën ku do të zhvilloj aktivitetet e saj. Çdo dëmtim të instalimeve nëmoksore tëqytetarëve është e obliguar t'i kthejë në gjendje të mëparshme me kosto të vetën financiare					
1	PUNËT PARAPRAKË				
1.1	Mobilizimi i ndërmarrjes për aktivitetet, vendosja e shenjave për sigurinë e komunikacionit për aktivitetet e punës në rrugë, në bashkëpunim me menaxherin e projektit, Të dhënat : L=1850,00 m' ; b=4,0m' ; bankinat 2x0,30m Të dhënat : bankinat 2x0,30m, kanal për ujërat atmosferik, 1m në të dy anët ku ka lëshesa. Llog m'	m	1850,00	4,00 €	7,400,00 €
1.2	Shënimet e trasës, si dhe përcjellja e punimeve gjeodezike gjatë ekzekutimit duke i trajtuar edhe elemente përcjellëse të rrugës si : Kyqja e rrugëve dytësore , interseptimi (kryqëzimi) në bazë të projektit zbatues,në matjet gjeodezike të përfshihen të gjitha punët e përmendura në kushtet e përgjithshme dhe teknike.Llog në m.Lmatjet gjeodezike në fund të projektit përfshihen të gjitha punët e kryera të sjellen hartat me kushtet e përgjithshme dhe teknike me gjeodet të lincemuar	m	1850,00	3,00 €	5,550,00 €
				Gjithsej: Pos 1	12,950,00
2	PASTRIMI DHE DEMOLIMI TERENIT				
2.1	Pastrimi i terenit largimi i drunjëve, shkurreve dhe rrethojave me tela xhembove dhe mbeturinat apo gjësendet tjera të ngurta që e pengojnë gjatë ekzekutimit të rrugës. Pastrimi i tyre bëhet normal me drejtimin e rrugës me gjërësi të përcaktuar me projekt sipas profilin tërthorë si dhe largimin e tyre në deponin më të afërt. Në këtë pozicion përfshihet edhe demolimi i rrethojave dhe kthimin në gjendje të mëparshme pas përfundimit të punimeve. Llog në m'.	m'	1850,00	3,00 €	5,550,00 €
2.2	Dislokimi i infrastrukturës nëmoksore (ujesjellës, kanalizimi, instalimet tregtare, instalimet telefonike dhe internetit) , në trasen e rrugës ku zhvillohen punimet e rrugës , zhvendosja e tyre jashtë rrugës në koordinim me institucionet përgjegjëse si KEDS , PFI , ujësjellësin rajonal. Në rast të dëmtimit eventual nga pakujdesia QK është i obliguar në afat sa më të shkurt të rikuperoj dëmtimet në kosto të vetë buxhetore në mënyrë që vendbanimet përreth rrugës e cila do të ndërtohet të mos mbesin pa shërbimet komunale. Llog në m' me të gjitha shpezoimet.	m'	1850,00	0,50 €	925,00 €
2.3	Pastrimi,zhbëllëqimi dhe mirëmbajtja e lëshesave ekzistuese ujore në aksin e rrugës në të dy anët e rrugës.	m'	1850,00	0,50 €	925,00 €
				Gjithsej: Pos 2	7,400,00

(Signature)

3	PUNIMET TORESORE				
Gërmimi dhe hapja e kanalit të kategorisë III-IV, deri në thellësinë dhe me gjerësi të nevojshme për punë duke përfshirë të gjitha pikat gjeodezike dhe detalet sipas projektit të dizajnuar në profilin gjatësorë dhe tërthorë. Në këtë pozicion përfshihet edhe hapja e kanaleve anësore, gërmimi dhe vendosja e lëshesave (tombinave) dhe elementet tjera përcjellëse të përcaktuara në projekt sipas kushteve teknike dhe përcjellësve. Si dhe detalet teknike. Në qmim përfshihet edhe ngjeshja me cilindër vibruar (pumpë vibruese) të pjesëve anësore dhe punimi i skarpatës. Dheut i tepër bartet në depozitë me të afërta deri 5.0km largësi. Vendje: Sigurimi					
3.1	Punët me makineri (90%)	m ³	1600.00	5.00 €	8,000.00 €
	Punët me dorë (10%)	m ³	178.00	4.00 €	712.00 €
Punimi i bazamentit (para mbushjes) me rrafshim dhe ngjeshje, si dhe rregullimi i pjerrtësisë tërthore dhe gjatësore të rrugëve sipas detalesve teknike të përfshira në projekt.					
3.2	Planifikimi dhe punimi i bazamentit të rrugës	m ³	888.00	5.00 €	4,440.00 €
Mbushja, nivelizimi, ngjeshja (kompaktimi) i me cilindër vibruar me pesë 12t deri në Mso=5000p/cm ² me të gjitha pjesët e tanesë ku është bërë gërmimi.					
3.3	Plotësimi, mbushja dhe Nivelizimi i trasës së rrugës me hartje të dhent të zgjedhur deri në plotësimin e kritereve të ngjeshjes sipas kritereve teknike të specifikuar në përshkrimin teknik të projektit.	m ³	888.00	0.50 €	444.00 €
Punimi i planimit dhe bankinave të rrugës dhe trotarëve me hartje të materialit shtrirje, rrafshim dhe ngjeshje me cilindër vibruar 18 tonë sipas kushteve përcjellëse dhe teknike të specifikuar në projekt.					
3.4	Punimi i planimit dhe bankinave	m ³	111.00	5.00 €	555.00 €
Gjithsej: Pos 3					14,151.00
4	PUNIMET E MBUSHJES (TAMPON)				
Furnizimi, transporti, shtrirja dhe punimi i shtrësës së rrugëve me zharvori nga gurët të thyer fraksion 0-63 mm, me trashësi të shtrësës t=20 cm të cilin i plotëson kushtet e parapara për tampion si dhe ngjeshja e tij me cilindër vibruar deri sa të fitohet moduli i ngjeshjes Mv=600 kg/cm ² . Sqrini : Pas përfundimit të kësaj shtrëse kompani punëkyese është e obliguar të shqyrtoj testin moduli të ngjeshjes dhe ta prezentoj tek menaxheri kontraktës.					
4.1	Furnizimi dhe punimi i shtrësës rrugëve me gurë të thyer fraksion 0-63 mm	m ³	1776.00	15.00 €	26,640.00 €
Furnizimi, transporti, shtrirja dhe punimi i shtrësës së rrugëve me zharvori nga gurët të thyer fraksion 0-31.5mm, me trashësi të shtrësës t=10 cm, të cilin i plotëson kushtet e parapara për tampion si dhe nivelizimi dhe ngjeshja me materialin e bankinave me të dy anet e rrugës me gjerësi (2 x 0.30 cm) dhe rrafje 4% ngjeshja bëhet me cilindër vibruar deri sa të fitohet moduli i ngjeshjes Mv=800 kg/cm ² . Sqrini : Pas përfundimit të kësaj shtrëse kompani punëkyese është e obliguar të shqyrtoj testin moduli të ngjeshjes dhe ta prezentoj tek menaxheri kontraktës.					
4.2	Furnizimi dhe punimi i shtrësës rrugëve me gurë të thyer fraksion 0-31.5 mm	m ³	888.00	16.00 €	14,208.00 €
Gjithsej: Pos 4					40,848.00
5	PUNIMET E LËSHESAVE (TOMBINAVE) DHE KANALEVE TË HAPURA				
Punimi i lëshesave, pjesëve kaluese dhe kanaleve të mbyllura në disa pjesë të rrugës sipas detalesve të dhëna në projekt. Në qmim është llogaritur hapja e kanalit dhe vendosja e rërës, furnizimi dhe vendosja e gypit atimua, duke duke përfshirë edhe koken hyrëse dhe dalje të lëshesës nga betoni armuar sipas detajit teknik të prezantuar në projekt llog në m' me të gjitha shpenzimet.					
5.1	Lëshes Ø 400mm deri 10 m gjatësi	m'	10.00	50.00 €	500.00 €
5.2	Punimi i kanalit të hapur atmosferik për kalimin e ujërave atmosferik nga skarpatë dhe lëshesat me lartësi dhe gjerësi të ndryshueshme konform konfiguracionit të terrenit të paraqitura në projektet tërthore dhe gjatësore për secilin stacionazh	m'	1850.00	1.00 €	1,850.00 €
Gjithsej: Pos 5					2,350.00



6	PUNIMET E MBISTRUKTURËS ASFALTIT DHE BETONIT				
6.1	Furnizimi, dhe punimi i vijës ndarëse në mes të dy shiritave të qarkullimit ,vij të plote dhe të ndërpre sipas rregullave të komunikacionit dhe vijat anësore . Llogaritjet komplet 3 flojet e vijave në m'	m ²	1,850.00	1.00	1,850.00
6.2	Demolimi i kokave të pasetave ekzistuese, si dhe ngritja dhe punimi i kokave të reja , përfundimi me armaturë , si dhe inkastimi i unazë metalike të kapakut të pusitë . Ngritja e kolës së puetave bëhet në nivel me kufiutën e asfaltit . Në qmim llogaritet edhe vendosja e kapakut të ri prej Gize DN 600 mm,deri 40t Llog për copë me të gjitha shpenzimet.	copë	5.00	190.00 €	950.00 €
6.3	Furnizimi, transporti dhe punimi i asfalt betonit nga materiali i njëtrajtshëm AH16 me trashësi e=8.0cm , në qmim përfshihet edhe zgjerimi nëpër kthesa . Vercjtje : Të mirren mostat në vend dhe të bëhet ATESTI -METODA MARSHAL I	m ²	7500.00	13.00 €	97,500.00 €
Gjithsej; Pos 6					100,300.00

REKAPITULIMI - ASFALTIMI E RRUGËS NË FSHATIN POTERQ - DUGAJEVE

1	PUNËT PARAPRAKË	12,950.00 €
2	PASTRIMI DHE DEMOLIMI TERENIT	7,400.00 €
3	PUNIMET TOKËSORE	14,151.00 €
4	PUNIMET E MBUSHJES (TAMPONI)	40,848.00 €
5	PUNIMET E LËSHESAVE (TOMBINAVE) DHE KANALEVE TE HAPURA	2,350.00 €
6	PUNIMET E MBISTRUKTURËS ASFALTIT DHE BETONIT	100,300.00 €
	TOTALI ME TVSH	177,999.00 €



REKAPITULIMI I PËRGJITHSHËM I ASFALTIMIT RRUGËVE NË POTERQ - DUGAJEVE

1	ASFALTIMI I RRUGËS	177,999.00 €
	TOTALI ME TVSH	177,999.00 €

8	NDËRTIMI I URËS L= 5 m				
Nr. rendor	Përshkrimi i pozicioneve	Njësia	Sasia	Çmimi njësi (€)	Çmimi total me TVSH (€)
1	PUNËT PARAPRAKË				
1.1	Pregaditja dhe fillimi i punimeve në hapjen e kantierit, punës për realizimin e punimeve për urën nga beton armicja. Llog. në komplet	komplet	1	200	200.00 €
1.2	Shënimi i kantierit me shenja informimi dhe rreziku gjatë kohës së zgjatit punimet deri në dorëzimin dhe inaugurimin e urës. Llog. në Komplet	komplet	1	200	200.00 €
1.3	Shënimi gjeodezik për realizimin dhe përcjelljen e punimeve në urën e planifikuar, dhe për përtëritja e trasës së krahës së shtrair të humit. Llog. do të regjullohet. Në qmim duhet të përcillen punimet në realizimin e të gjitha fazave të zgjedhurit. Llog. në m³	komplet	1	200	200.00 €
Gjithsej: Pos 1					600.00 €
2	PUNËT NË PASTRIMIN E TERENIT DHE DEMOLIMIT DHE RRENIMIT TË URËS EGZISTUESE				
2.1	Identifikimi i infrastrukturës nëntokësore (ujësjellës, kanalizime të kal, kablo elektrike, interneti apo të P.T.T. Llog. në paushall	komplet	1	500	500.00 €
2.2	Demolimi dhe rrenimi me kujdes të shtuar, për urën egzistuese. Vlen të theksohet se materiali i demohur duhet të bartet dhe të transportohet në vendet të cilin e cakton investitori. Llog. në komplet	komplet	1	500	500.00 €
2.3	Pastrimi i terrenit nga mbeturinat, e ngrota, shkurret, drunjtë, lugini i tyre në deponi, Deponin e cakton Investitori. Llog. në m³	m³	60	5	300.00 €
Gjithsej: Pos 2					1,300.00 €
3	PUNËT E DHIELT				
3.1	Gërmimi i humusit dhe lesit nga sipërfaqet e shtrair të humit me makinë nderimorë, në thellësi deri në (20- 30) cm, dhe njëkohësisht shlyerja e dheut në të dy anët e shtrair të humit. Llog. në m³	m³	68	5	340.00 €
3.2	Gërmimi i dheut të kategoris IV-të themeleve të shtyllave bregore, të mesme, dhe të mureve mbrojtëse në shtratin të humit dhe planifikimi i skenarëve me pjerësi sipas detajeve të dhëna në pjesën grafike Pjerësia nga (35 - 45) °. Në qmim të llogaritët edhe pompimi dhe largimi i ujit nga gropa e gërmuar e themelit, me kujdes të shtuar. Dheut e gërmuar të transportohet në vend të caktuar të cilin e definon organi mbikqyres. Llog. në m³	m³	95	5	475.00 €
3.3	Ri kthimi dhe rimbushja, ngjeshja e dheut në gropën e gërmuar me parë, pranë themeleve të shtyllave bregore të urës në shtratin e humit të përmendur ranje në dy anët e bregut kah mesi i shtrairit për 2 %. Llog. në m³	m³	65	2	130.00 €
Gjithsej: Pos 3					945.00 €

[Signature]

4 PUNËT E ZHAVORIT DHE GURIT					
4.1	Furnizimi, transporti dhe situarja e zhavorit nga guri i thyer me fraksione të ndryshme për konsolidim dhe stabilizim në gropën e gërmuar të themeleve për shtyllat bregore, në shtatën e lomit me trashësi deri 100 cm, ngjeshja të bëhet në çdo 20 cm, për themelet e mëdha Pas ngjeshjes të dokumentohet me atest ngjeshja e arritur Llog në m3	m ³	40	10	700,00 €
4.2	Furnizimi, transporti dhe vendosja e gurëve në shtatën e lomit me diam rreth 30 cm, të punohet rruja nga të dy anët e shtatit të lomit me 4% Llog në m ²	m ²	21	10	210,00 €
Gjithsej: Pos 4					510,00 €
5 PUNËT E BETONIT DHE BETON ARMES					
5.1	Furnizimi, transporti, dhe punimi i shtresës rrafshuese të betonit të varler nën themelet të shputave të shtyllave në shtatë të rregulluar me beton të vibruar dhe me aditive për papershkrutshmeri të ujit d. 10 cm, Me C-12/15 Punimet të kryhen sipas detaje grafike të dhëna për kesi lloj punimesh Llog. në m3	m ³	4	60	240,00 €
5.2	Furnizimi, transporti, dhe punimi i Betonit të klasit C-25/30 për shputat të themeleve bregore dhe pilakës në shtatën e lomit të rregulluar me pregaditje të kallopeve nga drusat si dhe betonimi i tyre, betoni duhet vibruar dhe shtuar aditive për papershkrutshmeri të ujit. Punimet të kryhen sipas standardeve dhe detaje grafike të dhëna për kesi lloj punimesh në llogaritjen statike Llog. në m3	m ³	12	150	1,800,00 €
5.3	Furnizimi, transporti, dhe punimi i betonit për shtyllat bregore me beton arme të klasit C-30/37 Me pregaditje të kallopeve nga drusat si dhe betonimi me beton me shtesa aditive dhe me vibrim me vibrator për kesi lloj të punimeve Punimet të kryhen sipas detajeve grafike të prezentuara në llogarin statike Llog. në m3	m ³	5	150	750,00 €
5.4	Furnizimi, transporti, dhe punimi i betonit për pjesën e mbisstrukturës sikur të paraqitur në pjesën konstruktive me punim të kutave dhe elementeve të shkurtra me beton arme të klasit C-30/37 Me pregaditje të kallopeve nga drusat dhe skeleve të renda me betonimi me beton me shtesa aditive për papershkrutshmeri nga uji dhe me vibrim me vibrator për kesi lloj të punimeve Punimet të kryhen sipas detaje grafike të paraqitura në llogarin statike Llog. në m3	m ³	9	150	1350



5.5	Furnizimi, transporti, dhe punimi i mureve bregore të urea me d = 20 cm të rregulluar me beton të vibruar dhe me aditive për papershkrushuesi ndaj njiut 1. =250 cm me beton C =25/30 Punimet të kryhen sipas detaje grafike të dhëna për kesi lloj punimesh.Llog. në m3	m	6	150	750,00 €
5.6	Furnizimi, transporti, dhe punimi i mureve të mbi pllakes me diam 25x20 cm, të rregulluar me beton të vibruar dhe me aditive për papershkrushuesi ndaj njiut me beton C =30/37 Punimet të kryhen sipas detaje grafike të dhëna për kesi lloj punimesh.Llog. në m3	m³	1	150	150,00 €
6	Gjithsej: Pas 5				5,040,00 €
PUNIMET E ARMIRIMIT					
6.1	Furnizimi i materialit ,pastrimi ,prejta lakimi ,si dhe montimi i armatures ne pozicionin e parapar sipas planit te armimit.Llog.kg	kg	4625	2	9,250,00 €
7	PUNË TË LIEËRA TË NDËRSHIME				9,250,00 €
7.1	Furnizimi i materialit per punimin e Gardhit metalik me elemente gypa nga eciili,nganjoi te punohet sipas detajit puntorik ,gardhi duhet te pastrohet dhe te lyhet me dy shtresa ngjyre minijumi anti koroziv si dhe me dy shtresa lyejje me ngjyr depressive per metale. Ngjyren e cakton organi mbikqyres me Investitorin Ankerimi i gardhit metalik realizohet me anker bolona per pllaken e e mbistrukturesne çdo 2.0 m gjatësi.Llog. Në m1.	m1	10,5	20	210,00 €
7.2	Furnizimi i materialit per punimin dhe montimin e l gypave PVC per instalime te nevojeshme ne të dy anët e shitegut për këmbesori me 2 075 mm Punimet te kryhen sipas detajit te prezntuar ne projekt .Llog. në m1	m1	22	10	220,00 €
7.3	Furnizimi i materialit per punimin dhe montimin e kanalizimit atmosferik për lëshesat e njiut prej gypave PVC Ø 160 mm Lëshesat duhet te pregaditen dhe punohetn sipas detajeve dhe elementeve konstruktive Kapaku i lëshesat duhet te jetë nga grilla e metalit nga giza e shkrirë.Distanca në mes të lëshesave e propozuar në çdo 4 m ...Llog. në copë.	copë	2	10	20,00 €
7.4	Furnizimi i materialit dhe punimin i l hidroizolimit vertikal te mureve bregore dhe horizontal në pjesën e mbistruktuës me një lyejje të fortë me bitull të lëngët dhe me kondor 4 mm ne dy shtresa me lyejje dhe pastria te siperfaqeve te cilat do te izoloohen Izolimi te realizohet me salldim me flake në te rrebet shtresat kalohen me +10 cm, Llog. në m2	m²	61,5	20	1,230,00 €
7.5	Pastrimi definitiv i kantierit punues të mës së betonit pas realizimit te punimeve për mura nga beton armeja .Llog. Në paushall	komplet	1	345	345,00 €
Gjithsej: Pas7					2,025,00 €

3	PUNË TË ASFALTIT				
8.1	Furnizimi, transporti dhe montimi i asfaltit betonit nga materiali i njëtrajtshëm AB16 me trashësi t=4,0cm, në shtim përfaqësohet edhe zgjerimi në përkatësi Vërejtje: Të miratuar në vend dhe të bëhet ATLASIT-METODA MARSHALL.	m ²	16,3	20	330,00 €
Gjithsej: Pas 8					330,00 €

B	REKAPITULIMI - NDERTIMI TË URËS
---	---------------------------------

1	PUNËT PARAPRAKË	600,00 €
2	PUNËT NË PASTRIMIN E TERENIT DHE DEMOLIMIT DHE RRENIMIT TË URËS	1,300,00 €
3	PUNËT E DHEUT	945,00 €
4	PUNËT E ZHAVORIT DHE GURIT	510,00 €
5	PUNËT E BETONIT DHE BETON ARMES	5,040,00 €
6	PUNIMET E ARMIRIMIT	9,250,00 €
7	PUNË TË TJERA TË NDËRSHME	2,025,00 €
8	PUNË TË ASFALTIT	330,00 €
	TOTALI ME TVSH	20,000,00 €

C	Riparimi i urës në Poterq L=74m				
1	Përshkrimi i Punëve	Mësimi	Sasia	Qëllimi	Totali
1	Demolimi i disa drasave të vjetra dhe të demtoreve si dhe riparimi si dhe shtimi i konstruksionit metalik sipas nevojë si dhe përgatitja e urës për montimin e drasave të reja.	komplet	1	201,00 €	201,00 €
2	Furnizimi transporti dhe montimi i drasave me dimensione 4.10mx0.22cm si dhe t=0.5cm në cmim hyr dhe bulonat dhe elementet tjera përcjellese për montimin e drasave.	copë	100	6,00 €	600,00 €
3	Furnizimi transporti dhe montimi i drasave me dimensione 5.00mx0.15cm si dhe t=0.3cm në cmim hyr dhe bulonat dhe elementet tjera përcjellese për montimin e drasave.	copë	400	13,00 €	5,200,00 €
					6,001,00 €

A	REKAPITULIMI I PËRGJITHSHËM I ASFALTIMIT RRUGËVE NË POTERQ - DUGAJ VË-	177,999.00 €
B	NDËRTIMI I URËS L= 5 m.	20,000.00 €
C	Riparimi i urës në Poterq L=74m	6,001.00 €
	Totali :	204,000.00 €

KUSHTET E PËRGJITHSHME

Numri i kontratës: 634-24-6218-5-2-1/C785

Neni 1 Përkufizimet

1.1 “Kontratë” do të thotë marrëveshje të lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Kontraktuesit, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkorporuar me referencë në të.

1.2 “Punë” konsiderohen të gjitha ato punë të cilat janë objekt i kontratës dhe të cilat Autoriteti Kontraktues kërkon që të kryhen nga kontraktuesi, qofshin ato ndërtim, restaurim, meremetim apo rrënim ndërtesash, pajisje, struktura inxhinieringu civil, struktura të tjera apo pjesë të tyre.

1.3 “Kontraktuesi” është operatori ekonomik (apo grupi i operatorëve ekonomik), i caktuar në formularin e kontratës, i cili (të cilët) është palë në kontratë dhe është i obliguar të kryejë punët sipas marrëveshjes dhe i cili do të marrë shumën sipas marrëveshjes me kontratë.

1.4 “Menaxheri i Projektit” është njeriu i caktuar në kushtet e veçanta të kontratës (apo cilido njeri kompetent i autorizuar nga Autoriteti Kontraktues), i cili është përgjegjës për mbikëqyrjen e kryerjes së punëve dhe për të gjitha hollësitë duhet t’i raportojë Autoritetit Kontraktues.

1.5 “Çmimi Kontratës” do të thotë shuma që i paguhet Kontraktuesit sipas marrëveshjes në formularin e kontratës.

1.6 “Vendi i ndërtimit” do të thotë vendi i caktuar për kryerjen e punëve të kontraktuara.

1.7 “Pajisjet e kontraktuesit” do të thotë e tërë makineria përfshirë edhe atë për bartjen e pajisjeve, dhe mjetet tjera që nevojiten për kryerjen e punëve të kontraktuara që duhet të bëhen sipas kontratës.

1.8 “Skicat” nënkuptojnë vizatimet, llogaritjet, informatat e siguruar dhe të miratuara nga Autoriteti Kontraktues për kryerjen e punëve të kontraktuara.

1.9 “KPK” do të thotë Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.

1.10 “KVK” do të thotë Kushtet e Veçanta të Kontratës.

Neni 2 Gjuha dhe ligji i aplikueshëm

2.1 KVK e saktësojnë cili është ligji që i përcakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.

2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVK.

Neni 3 Transferimi

3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Kontraktuesi e transferon kontratën e vet ose një pjesë të saj te një palë e tretë.

3.2 Kontraktuesi nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues, ta transferojë kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përfitim apo interes nga ajo, përveç në këto raste:

a) kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankierëve të Kontraktuesit, të shumave që duhet të paguhen ose që do të bëhen borxh sipas kontratës; ose

b) në rast të dhënies së të drejtës së Kontraktuesit siguruesve të Kontraktuesit për të kërkuar pagesën nga ndonjë person tjetër i detyruar në rastet kur siguruesit e kanë shkarkuar humbjen ose detyrimin e Kontraktuesit.

3.3 Për qëllimet e nenit 3.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lirojë Kontraktuesin nga obligimet e veta për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është bartur.

3.4 Pranuesit e dispozitave të kontratës duhet të plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për dhënien e kontratës përveç në raste kur transferimi bëhet në bankë apo kompani të sigurimit ose institucion tjetër financiar.

Neni 4

Nën-kontraktimi

4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Kontraktuesi ia beson realizimin e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë.

4.2 Elementet e kontratës që do të nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura Autoritetit kontraktues me rastin e dorëzimit të ofertës. Në rast të ndryshimit të nënkontraktuesve gjatë implementimit të kontratës, Kontraktuesi duhet të njoftoj me shkrim Autoritetin Kontraktues. Autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Kontraktuesin për vendimin e vet brenda 30 ditë pune nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi. Kontraktuesi nuk nënkontraktton pa autorizim me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Të gjithë nënkontraktuesit e propozuar duhet të përmbushin kërkesat e përshtatshmërisë.

4.3 Autoriteti kontraktues nuk njih lidhje kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve, megjithatë mund të siguroj, ku e konsideron si të nevojshme, pagesat direkte për nënkontraktorët.

4.4 Kontraktuesi është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agjentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si po të ishin akte, gabime ose neglizhencë e Kontraktuesit, agjentëve të tij ose punëtorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjese të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Menaxherit të Projektit nuk e liron Kontraktuesin nga obligimet e tij sipas kontratës.

4.5 Nëse nënkontraktuesi ka marrë ndonjë obligim të vazhdueshëm që vazhdon për një periudhë që e tejkalon atë të periudhës së garancisë nën kontratë ndaj Kontraktuesit, përkritazi me furnizimet që i jep nënkontraktuesi, Kontraktuesi duhet që, në çfarëdo momenti pas skadimit të periudhës së garancisë, t'i transferojë menjëherë te Autoriteti kontraktues, me kërkesë dhe shpenzime të Autoritetit kontraktues, përfitimet e obligimeve të tilla për kohëzgjatjen e garancisë së skaduar.

OBLIGIMET E AUTORITETIT KONTRAKTUES

Neni 5

Dhënia e dokumenteve

5.1 Nëse është e nevojshme, brenda 30 ditësh nga nënshkrimi i kontratës, autoriteti kontraktues duhet t'i japë Kontraktuesit, pa pagesë, një kopje të skicave të përgatitura për realizimin e kontratës dhe kopje të specifikimeve dhe dokumenteve tjera të kontratës. Kontraktuesi mund të blejë kopje tjera të këtyre skicave, specifikimeve dhe dokumenteve tjera, në rast se ato janë në dispozicion. Pas lëshimit të certifikatës përfundimtare, Kontraktuesi duhet t'i kthen autoritetit kontraktues të gjitha skicat, specifikimet dhe dokumentet tjera të kontratës.

5.2 Përveç nëse është e nevojshme për qëllime të kontratës, skicat, specifikimet dhe dokumentet tjera që i jep autoriteti kontraktues nuk duhet të përdoren as nuk duhet t'i komunikohen një pale të tretë nga Kontraktuesi pa pajtim paraprak të autoritetit kontraktues.

5.3 Autoriteti kontraktues ka autoritetin për t'i lëshuar Kontraktuesit urdhra administrative që inkorporojnë ato dokumente plotësuese dhe udhëzimet që janë të nevojshme për ekzekutim të mirë të kontratës dhe për kompensim dëmi nga ndonjë defekt të saj.

Neni 6

Qasja në vend punishte

6.1 Autoriteti kontraktues, në kohën e duhur dhe në përputhje me ecurinë e punimeve, do t'i jap qasje dhe akses Kontraktuesit në vend punishte, në përputhje me programin e zbatimit të detyrave të përcaktuara në këto Kushte të përgjithshme.

6.2 Kontraktuesi, gjatë shfrytëzimit, duhet të mirëmbajë çdo objekt të vendosur në dispozicion të tij në gjendje të mirë, dhe duhet, nëse kërkohet nga Autoriteti Kontraktues, t'i kthejë ato në gjendjen e tyre origjinale pas përfundimit të kontratës.

6.3 Kontraktuesi nuk do të ketë të drejtë të ndonjë pagese për përmirësimet që rezultojnë nga puna e kryer me iniciativën e tij.

Neni 7

Ndihma lidhur me rregulloret vendore

7.1 Kontraktuesi mund të kërkojë ndihmën e Autoritetit kontraktues për marrjen e kopjeve të ligjeve, rregulloreve dhe informatave mbi zakonet, urdhërat apo ligjet anësore të Republikës së Kosovës të cilat mund të ndikojnë te Kontraktuesi gjatë realizimit të obligimeve të tij me kontratë. Autoriteti kontraktues mund ta japë ndihmën e kërkuar Kontraktuesit me shpenzime të Kontraktuesit.

7.2 Në bazë të dispozitave të ligjeve dhe rregulloreve mbi punën, Autoriteti Kontraktues do të bëjë të gjitha përpjekjet e nevojshme për të lehtësuar prokurimin nga Kontraktuesi për të gjitha vizat dhe lejet e nevojshme, duke përfshirë lejen e punës dhe lejet e qëndrimit, për personelin, shërbimet e të cilëve Kontraktuesi dhe Autoriteti kontraktues i konsideron të nevojshme, si dhe lejet e qëndrimit për familjet e tyre.

OBLIGIMET E KONTRAKTUESIT

Neni 8 Obligimet e Kontraktuesit

8.1 Kontraktuesi duhet të veprojë sipas urdhrave administrative që i jep autoriteti kontraktues. Nëse Kontraktuesi konsideron se kërkesa e një urdhri administrativ shkon përtej fushëveprimit të kontratës, ai, duke iu ekspozuar dënimit për shkelje të kontratës, do ta njoftojë autoritetin kontraktues për këtë duke i paraqitur arsyet e tij brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrit. Ekzekutimi i urdhrit administrativ nuk do të pezullohet për shkak të këtij njoftimi.

8.2 Kontraktuesi duhet t'i respektojë dhe të veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës dhe do të sigurojë që personeli i tij, të afërmit e tyre, dhe punëtorët vendorë të tij gjithashtu t'i respektojnë dhe të veprojnë sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve.

8.3 Kontraktuesi duhet t'i trajtojë të gjitha dokumentet dhe informatat e marra lidhur me kontratën si private dhe konfidenciale. Përveç në rastet kur kjo është e nevojshme për qëllime të ekzekutimit të kontratës, ai nuk do të publikojë ose shpalosë asnjë detaj të kontratës pa pajtim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues.

8.4 Nëse Kontraktuesi është grup, përbërja e grupit nuk do të ndryshohet pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit kontraktues.

8.5 Kontraktuesi do të siguroj se punët do të fillojnë dhe të përfundojnë brenda afatit të caktuar rënë dakord në programin e bërë sipas Nenit 12.

8.6 Kontraktuesi do të siguroj që të gjitha punët që ai/ajo do të bëjë, si dhe riparimin e defekteve gjatë realizimit të punimeve do të bëhen në kohë dhe në përputhje me standardet, praktikat, metodat dhe procedurat ekzistuese dhe për më tepër me shkallën e aftësisë dhe zellit, e cila do të pritet nga një kontraktues i aftë dhe me përvojë që ka ndërmarr punë të ngjashme.

8.7 Kontraktuesi do të siguroj për cilësinë e punës dhe për cilësinë e materialeve dhe cilësisë profesionale të punonjësve që janë përdorur për realizimin e punëve të kontraktuara.

8.8 Kontraktuesi duhet të siguroj zonën e ndërtimit menjëherë pas fillimit të punës për arsyet e mëposhtme:

- a. në qoftë se për kryerjen e punëve pajisjet e rënda si: ekskavatorë të llojeve të ndryshme, vinça, kamionë të llojeve të ndryshme, skela të larta, etj do të përdoren dhe
- b. në mënyrë që të mos dëmtojë kalimtarët e rastit, objektet përreth, trafikun etj.

8.9 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për sigurinë e të gjitha aktiviteteve në vend punim.

Neni 9 Personeli

9.1 Kontraktuesi duhet të punësoj personel kyç dhe të përdor pajisje të identifikuar në tender e tij, për të kryer punë ose personel tjetër dhe pajisje të aprovuara nga menaxheri i projektit. Menaxheri i Projektit do të aprovoj çdo zëvendësim të propozuar të personelit kyç dhe pajisjeve vetëm nëse kualifikimet e tyre përkatëse, ose karakteristikat janë në thelb të barabarta ose më të mirë se ato të propozuara gjatë tenderit.

Neni 10 Siguria e ekzekutimit

10.1 Kontraktuesi do të, jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, furnizoj Autoritetin Kontraktues me siguri për ekzekutim të plotë dhe të mirë të kontratës. Shuma e sigurisë do të saktësohet në KVK. Siguria e ekzekutimit do të ndalet nga pagesa e Autoritetit kontraktues për çfarëdo humbjeje që është pasojë e mosekzekutimit të plotë dhe të duhur të obligimeve kontraktore nga ana e Kontraktuesit.

10.2 Sigurimi do të vazhdoj të mbetet i vlefshëm 30 ditë pas lëshimit të Certifikatës së Pranimit të Përkohshëm.

10.3 Siguria e ekzekutimit të kontratës do të jetë në formën e dhënë në pjesën IV të kontratës.

Neni 11 Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit

11.1 Nga data e fillimit e deri sa të lëshohet Certifikata e Korrigjimit të Defekteve, rreziqet e lëndimeve personale, vdekja, dhe humbja ose dëmtimi i pronës (përfshirë, pa kufizim, Punët, Impiantet, Materialet, dhe Pajisjet) janë rreziqet e Kontraktuesit dhe pronës së afërt.

11.2 Kontraktuesi duhet të sigurojë një sigurim nga dita fillimit të punimeve deri në fund të periudhës garantuese të defekteve në shumat e përcaktuara në KVK për ngjarjet e mëposhtme të cilat janë për shkak të rreziqeve të Kontraktuesit:

- (a) humbje ose dëmtim i Punëve, Impianteve dhe Materialeve;
- (b) humbje ose dëmtim i Pajisjeve;
- (c) humbje ose dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën; dhe
- (d) dëmtim ose vdekje e personelit të tij.

11.3 Kontraktuesi brenda 15 ditëve pas nënshkrimit të kontratës duhet t'i dërgojë Autoritetit Kontraktues policën dhe certifikatën për sigurim që ka për qëllim kompensimin e nevojshëm për të siguruar humbjen apo dëmet e pësura.

11.4 Në qoftë se kontraktuesi nuk ofron një sigurim të tillë atëherë kontrata do të konsiderohet e anuluar dhe kontraktuesi do të përjashtohet nga pjesëmarrja në aktivitetet e prokurimit për jo më pak se një vit.

11.5 Në qoftë se ekzistojnë arsye të mjaftueshme dhe bindëse për zgjatjen e afatit të ofrimit të certifikatës mbi sigurim, Autoriteti Kontraktues mund të zgjasë afatin e caktuar për dorëzimin e certifikatës mbi sigurimin ose të eliminojë sigurimin dhe të zbrësë çmimin e shpërblimit nga lëtimi i kontraktuesit.

Neni 12 Programi

12.1 Brenda kohës së specifikuar në KVK, kontraktuesi do t'i dorëzojë Menaxherit të Projektit një program për miratim. Programi do të përmbajë së paku me se vijon: mënyrën se si Kontraktuesi propozon ekzekutimin e punëve, afatin kohor që kërkohet për dorëzim dhe miratim të vizatimeve, metodat e përgjithshme që do të zbatohen, dhe afatin kohor për secilin aktivitet të specifikuar.

